



UNMIK/REG/2008/5
8 shkurt 2008

RREGULLORE NR. 2008/5

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI BLETARINË TË MIRATUAR NGA
KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) e datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, të datës 16 prill 2007 lidhur me Ligjin mbi bletarinë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 mars 2007,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi bletarinë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji Nr.02/L-111) i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nënshkruar sot, më 8 shkurt 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm